

VENDIM
Nr. 169, datë 11.4.1997

**PËR PROKURIMIN ME PROCEDURE TË PËRSHPEJTUAR PËR DISA ARTIKUJ QË
LIDHEN ME PLOTËSIMIN E NEVOJAVE URGJENTE PËR FUNKSIONIMIN E
BURGJEVE DHE INSTITUCIONEVE TË RIEDUKIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vetëm për plotësimin e nevojave që lidhen me funksionimin e burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit, për artikuj ushqimorë, veshmbathje, kazermim dhe ndërlidhje, të përdoret “Kërkesa për kuotim” me kushtet vijuese:

a) Koha e përgatitjes së ofertës të jetë jo më pak se 1-3 ditë.
b) Shoqërisë fituese t’i kërkohet si dokumentacion ligjor vetëm licenca e ushtrimit të veprimtarisë. Kjo të pranohet edhe e panoterizuar, me kusht që komisionit t’i paraqitet origjinali për verifikimin e besueshmërisë së fotokopjes.

c) PAGESA e mallrave, shërbimeve të bëhet me lekë në dorë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve autorizohet të përcaktojë të gjitha nevojat që lidhen me funksionimin e burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i zbatueshëm për periudhën 1.4.1997 gjer më 30.6.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino